



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë ,më 11.06.2026

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

(“BLERJE GOMA PËR AUTOMJETET E BASHKISË KRUIJË”)

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 11.06.2026 ne Kruje ,nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin **nr.301 datë, 09.06.2026**, me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit ‘E Hapur e Thjeshtuar ’, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: ‘Blerje goma për automjetet e Bashkisë Krujë’

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34350000-5/(Goma per automjete te renda/lehta)

VLERA E FONDIT LIMIT: 2’220’600 (dymiljon e dyqind e njezetëmijë e gjashtëqind) lekë pa t.v.sh,

BURIMI FINANÇIMIT : të Ardhurat e Bashkisë Krujë +Transferta Specifike.

LLOJI I PROCEDURES SE PROKURIMIT: PROCEDURE E HAPUR E THJESHTUAR .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;(Ne vleren prej 2% te fondit limit te kontrates objekt prokurimi)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2026 per secilin operator).*

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2026 per secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2-a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës, që prokurohet përkatësisht në shumën prej **888’240(teteqind e tetedhjetë e tete mijë e dyqind e dyzet) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

Vlera e marzhit të xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nje kufiri te ulet dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatorët ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme të sukseshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në të lehtësimin e furnizimit të mallrave si më poshtë:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se vlera **444'120(katerqind e dyzet e kater mije e njeqind e njezet) leke pa t.v.sh,** dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Vlera ne kufirin e percaktuar ne VKM nr 285 date 19.05.2021, eshte percaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkine Kruje), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje mallrat objekt kontrate, ne vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij qe ka ne dispozicion sipas kerkeses se AK. (Deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se ... **Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.**” Disponueshmeria e furnizimit nga ana e OE eshte kerkese ekzigjente nga ana e AK, pasi mallrat objekt prokurimi, I sherbejn jo vetem institucionit te Bashkise Kruje por edhe objekteve arsimore te varesise se ketij institucioni e per pasoje permbushja ne kohe dhe disponibiliteti ne furnizim eshte domosdoshmeri per realizimin me sukses te kontrates.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr	Emertimi i mallit / produktit	Tipi i mjetit	Targa	Njesia	Sasia	30 DITE	30 DITE
1	Goma 315 / 80 / R 22.5	Kamion tip Iveko Fiat	KR 26-74 A	Copë	6		
2	Goma 315 / 80 / R 22.5	Kamion tip Mercedes - Benz vetëshkarkues	KR 82-35 A	Copë	6		
3	Goma 10 / 00 / R 22.6	Kamion teknologjik tip Volvo trans.mbet. urb. Nj.Ad. Nikël , Fushë - Krujë	AA 899 DH	Copë	6		
4	Goma 315 / 70 / R 22.5	Kamion teknologjik tip Mercedes - Benz trans. mbet, urb. Nj.Ad Fushë Krujë	AA 038 SI	Copë	4		
5	Goma 315 / 80 / R 22.5	Kamion teknologjik tip Mercedes - Benz trans. mbet, urb. Nj.Ad Fushë Krujë	AA 038 SI	Copë	4		
6	Goma 215 / 75 / R 16	Automjet tip Ford	KR 48-50 A	Copë	4		
7	Goma 255 / 50 / R 20	Fuoristrade tip Mercedes - Benz ML 320 CD	AA 663 KN	Copë	2		
8	Goma 255 / 50 / R 19	Fuoristrade tip Mercedes - Benz	AB 987 BU	Copë	4		
9	Goma 225 / 70 / R 15 C	Kamioncine tip Mercedes - Benz	AA 328 NU	Copë	4		
10	Goma 315 / 80 / R 22.5	Kamion teknologjik tip DAF trans. mbet, urb. Nj.Ad Bubq	AB 601 UA	Copë	8		
11	Goma 315 / 80 / R 22.5	Kamion teknologjik tip DAF trans. mbet, urb. Nj.Ad Thumanë	AB 341 GO	Copë	8		
12	Goma 235 / 75 / R 17.5	Kamioncinë tip Mercedes - Benz (vincì)	AB 448 BP	Copë	2		
13	Goma 10 / 00 / R 22.6			Copë	4		
14	Goma 255 / 50 / R 20			Copë	2		
15	Goma 255 / 50 / R 19			Copë	4		
16	Goma 315 / 80 / R 22.5			Copë	9		
17	F.v. pulla të ndryshme për goma			Copë	50		
18	Shërbime në rrugë me mjet te posaçëm			Copë	10		

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e *artikujve objekti prokurimi* sipas listes se miratuar ne preventivin perkates është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorise se

Sherbimeve dhe Investimeve Publike **nr.4360 Prot, date 02.06.2026**, duke indentifikuar per cdo pajisje specifikimin dhe karakteristikat perkatese teknike.te cilat plotesojne nevojat respektive te Bashkise Kruje ne mirembajtjen *ne gatishmeri operative te mjeteve te transportit me qellim permbushjen e funksioneve te procesve te ndryshme te punes ne raport me mirembajtjen e permiresimin e infrastrukturen publike*, dhe me konkretisht ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te normave perkatese te Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 ‘‘Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore’’, kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

- *Specifikimet teknike të përcaktuara për gomat e automjeteve objekt prokurimi janë hartuar në funksion të natyrës së përdorimit të tyre ne perdorimin e automjeteve ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe qëndrueshmërie në punë. Këto materiale do të përdoren në kushte operative te mjeteve motorike te Bashkise Kruje dhe që kërkojnë pajisje të certifikuara, me parametra të qartë teknikë dhe me performancë të garantuar.*
 - Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e mallit që prokurohet, duke e përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.
 - Sa i perket standartit te tyre per cdo artikull ato jane hartuar duke marre ne konsiderate percaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit te pranuar te tregut si dhe kerkesat perkatese te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
 - Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive. Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’ i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet ‘‘markë’’,’’standart respektiv i referuar ‘‘ do te pranohet termi ‘‘ose ekuivalent i tij/i saj’’.
 - Argumentim: Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 ‘‘Specifikimet teknike’’ të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’ i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 ‘‘Kërkesat e cilësisë’’ të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’’ i ndryshuar.
- **Fondi limit** per proceduren me objekt , ‘‘**Blerje goma për automjetet e Bashkisë Krujë**’’, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin

76 te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

PER NJESINE E PROKURIMIT PUBLIK